

Asambleja e Aksionereve

Vendim
Nr 65 date 24.7.09

Per nje ndryshim ne vendimin nr.152 date 22.12.2008 "Per miratimin e raportit te ekspertit vleresues dhe zmadhimin e kapitalit te Shoqerise Korca 2008 sh.a

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve e "Korca 2008" sh.a pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Administratori dhe Keshilli Mbikqyres i Korca 2008 sh.a si dhe duke u bazuar ne nenin 135,168 e ne vijim te Ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare"

VENDOSI

Pika 2 e vendimit nr.152 date 22.12.2008 "**Per miratimin e raportit te ekspertit vleresues dhe zmadhimin e kapitalit te Shoqerise Korca 2008 sh.a**"
Ndryshon si me poshte :

1. Miratimin e zmadhimit te kapitalit te "Korca 2008" sh.a sipas raportit te ekspertit kontabel te autorizuar zj.Etleva Ashiku .Kapitali themeltar i shoqerise "Korca 2008" sh.a pas zmadhimit behet 87 929 000 leke
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Administratori i Shoqerise
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

Kryetari i Keshillit Bashkiak

Gjergji PENDAVINJI



VENDIM

Nr 152 date 22.12.08

Per miratimin e raportit te ekspertit vleresues dhe zmadhimin e kapitalit te Shoqerise "Korca 2008" sh.a

Ne baze te nenit 135, 168 e ne vijim te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" "Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Administratori i Shoqerise

VENDOSI

1. Miratimin e raportit te ekspertit vleresues Znj. Silva Mecaj.
2. Miratimin e zmadhimit te kapitalit te "Korca 2008" sh.a. sipas raportit te ekspertit kontabel te autorizuar ne masen 85 929 000 leke. Kapitali i shoqerise "Korca 2008" sh.a ka qene 2 000 000 dhe pas zmadhimit kapitali themeltar i shoqerise behet 87 929 000 leke.
3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Administratori i Shoqerise
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere



KRYETARE

Raimonda NASE

Raimonda Nase

VENDIM

Nr 95 date 13.12.2013

**Per miratimin e raportit te eksperteve kontabel dhe zmadhimin e kapitalit
te Korca 2008 sh.a**

Asambleja e Pergjithshme e aksionareve, bazuar ne nenin 168 e ne vijim te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare ", i ndryshuar, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Keshilli Mbikqyres

VENDOSI

1. Te miratoje raportin e eksperteve kontabel per zmadhimin e Kapitalit te Shoqerise Korca 2008 sh.a, sipas tekstit bashkengjitur ketij vendimi
2. Te Zmadhoje e kapitalin e Shoqerise "Korca 2008" sh.a me kontributin ne natyre, truall 22 800 m2 te ndodhur ne ZK 8564, rregjistruar ne emer te Bashkise Korce, si me poshte:
 - a. Kapitali ishte 87 929 000 lek.....behet 407 129 000 lek
3. Zmadhimi i kapitalit behet nepermjet ritjes se vleres nominale te aksionit, si me poshte:
 - a. Vlera nominale e aksionit ishte 87 929 lek..... behet 407 129 lek
4. Ndryshimet e mesiperme te pasqyrohen ne Statutin e Shoqerise.
5. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen organet drejtuese te "Korca 2008" sh.a
6. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

Firmos me ulësinë
e nën kryetarit të keshillit
të Bashkisë Korçë
Ejona Mexhupaj
Gjyly



KRYETARE

Raimonda NASE

Ejona Mexhupaj
Gjyly

SHOQERISE

“KORCA 2008” SH.A

Raport

Zmadhim Kapitali

Përgatitur nga :

Eksperte Kontabël te Regjistruara

Ilda Ekonomi Anila ÇUNOTI

Korçë, 02 Dhjetor 2013

RAPORT I EKSPERTEVE KONTABEL TE REGJISTRUARA

PER ZMADHIM KAPITALI

KORCA 2008 SH.A.

NIPT K84329001E

KORCE

Te nderuar zoterinjt!

Shoqeria KORCA 2008 Sh.A. KORCE me NIPT K84329001E me Vendim te Asamblese te Pergjithshme te Aksionereve nr 26 date 29.03.2013 ka vendosur per zmadhimin e kapitalit me kontribut ne natyre.

Shoqeria KORCA 2008 Sh.A. eshte themeluar ne daten 18.07.2008 ne baze te Vendimit te Keshillit Bashkiak Korce Nr. 85 date 26.11.2007 ne mbeshteje te ligjit Nr.7926 date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarjeve shteterore ne shoqeri tregtare"si dhe ne baze te Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008"Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe eshte regjistruar si shoqeri tregtare prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne daten 29.07.2008 e pajisur me NIPT K84329001E.

Aksioner i kesaj shoqerie eshte Keshilli Bashkiak Korce i cili zoteron 100 %te aksioneve.

Kapitali fillestar i shoqerise ne momentin e krijimit ishte 2.000.000 leke. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve ne vitin 06/08/2009 me nr ceshtje CN -277564-07-09 kapitali i shoqerise ka arritur ne 87.929.000 leke si shtese e kontributit ne natyre te vleres se nderteses.

Numri i aksioneve eshte 1.000 aksione me vlere nominale 87.929

Ilda Ekonomi

Eksperte Kontabel

Nr. Lic 183

Nipt K84329001E



Selia e shoqerise ndodhet Lagjen 17 Rruga Midhi Kostani,prane hipotekes

Objekti i veprimtarise prodhim perpunim dhe montim i pajisjeve metalike,kryerja e aktiviteteve tregtare dhenia dhe marja me qira e objekteve dhe funksionimi i transportit publik etj.

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- Keshilli Mbikqyres
- Administratori

Anetare te Keshillit Mbikqyres jane

Anxhela Qeramixhi

Spiro Taba

Ana Verushi

Administrator i shoqerise eshte Eris PAPA.

Statusi i shoqerise eshte aktiv ne baze te ekstraktit historik te leshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit date 21.11.2013.

Shoqeria nuk ka zhvilluar aktivitetin e saj per te cilen eshte krijuar.

Ne baze te Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008"Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare"Titulli 5 Kreu 1 ,ne Nenet 168 dhe 177 te tij si dhe Ligjit Nr 9228 date 29.04.2004 i ndryshuar me Ligjin Nr 9477 date 09.02.2006 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe konkretisht Nenet 4,7,9,10 dhe 16 si dhe Ligjit Nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" regullores se percaktuar ne statut e akt themelimi te shoqerise ,si dhe ne mabe te Vendimit ner 26 date 29.03.2013 te Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve ka miratuar ne parim zmadhimin e kapitalit te shoqerise dhe emerimin e Z.Jani STRATOBERDHA si Ekspert Vleresues i Pasurive te Paluajtshmememe nr License 316 .

Me vendim te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise Korca 2008 Sh.A. nr 27 date 29.03.2013 jemi caktuar me detyren e Eksperteve per zmadhimin e kapitalit

Ilda Ekonomi

Ekspert Kontabel i Regjistruar

Nr. Lic 179

Nr. T: KB4631001A



Si Eksperte te caktuara per vleresimin e kontributit jemi mbeshtetur ne Legjislacionin e mesiperem si dhe ne Raportin e Vleresimit te Ekspertit Vleresues Jani STRATOBERDHA te dates 30.10.2013 sipas te cilit vlere e truallit prone e Bashkise Korce eshte 319.200.000 leke.

Ne baze te ketyre dokumentave ne konkludojme se ka mundesi per zmadhim kapitali per shoqerine Korca 2008 Sh.A. me kontribut ne natyre (truall)

Shoqeria Korca 2008 Sh.A . mund te zmadhoje kapitalin me vleren 319.200.000 (treqind e nentembedhete mije e dyqind mije) leke truall duke ndryshuar vleren nominale te aksioneve dhe keshtu vlere e kapitalit te shoqerive do te arrije ne 407.129.000 leke

Numri i aksoneve mbetet 1.000 aksione me vlere nominale 407.129 leke

Veprimi kontabel pas zmadhimit te kapitalit do te jene si me poshte:

Kredi : llog 101 "Kapitali".....319.200.000 leke

Debi : Llog 211" Truall ".....319.200.000leke

Ndryshimet e mesiperme ne zerat e PF do te pasqyrohen si ne tabelen e meposhtme.

Ne Pasiv te Pasqyrave Financiare

Emertimi	Ishte	Behet
Kapitali aksioner	87.929.000	407.129.000

Ne Aktiv te Pasqyrave Financiare

Emertimi	Ishte	Behet
Truall	0	319.200.000

Per caktimin e vleres ne te cilen do te behet ky zmadhim kapitali duhet te shprehet mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme te Aksionereve.

Per kryerjen e misionit te ngarkuar jemi mbeshtetur ne:

Ilda Ekonomi

Ekspert Kontabel i Regjistruar

[Signature]

NIPT:



- Vendimin e Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve te shoqerise Korca 2008 Sh.A. nr 26 date 29.03.2013 per zmadhimin e kapitalit.
- Raportin e Vleresimit et Vleresuasit et Pasurive te Paluajtshme Z.Jani STRATOBERDHA date 30.30.10.2013.
- Pasqyren e levizjes se kapitalit
- Ekstraktin historik te shoqerise prane QKR
- Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", Ligjit Nr 9228 date 29.04.2004 I ndryshuar "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- Dokumenta te tjere ligjore te shoqerise

Ky raport u plotesua ne pese kopje te njejta nga te cilat tre kopje I jepen shoqerise dhe dy kopje i mbajne Ekspertet Kontabel te Regjistruar .

Ekspert Kontabel I Regjistruar

Korce me 02.12.2013

Ilda EKONOMI

Anila ÇUNOTI



RAPORT VLERËSIM

ME OBJEKT:

“VLERËSIM I PASURISË SË
PALUAJTSHME, TRUALL, NR. 4/33,
ZONA KADASTRALE NR. 8564.
NË EMËR TË BASHKIA KORÇE”

Me porosi dhe për llogari të
Te vete interesuarit

Ekspert Vlerësues
Jani Stratobërdha

JANI STRATOBËRDHA
VLERËSUES I PASURITË
TE PALUAJTESHME
NIPT: K 74124003L
TEL: 0822 54954E KORÇE

Instruksion

1. Zotërimi i Pronës
2. Vendndodhja e Pronës
3. Sipërfaqet
4. Urbanistika dhe Infrastruktura
5. Përshkrimi i Pronës
6. Vlerësimi
7. Konkluzione
8. Rezervime
9. Plan Vendosja dhe Dokumentacioni Ndihmës

Instrukcion

Unë i quajhuri Jani Stratobërdha, me profesion ekonomist, në cilësinë e ekspertit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, me Çertifikatë Nr. 316 dt. 18.03.2010, si dhe i regjistruar pranë organeve tatimore Q.K.R. si person i tatueshëm, me numër identifikimi personal K74124003L, në vijim të kërkesës të **Bashkise Korçe**, përgatis dhe dorëzoj këtë raport vlerësimi për pronën objekt vlerësimi, trual, i ndodhur në qytetin e Korçës.

Për realizimin e vlerësimit të pronës në fjalë, jam mbështetur tek “**Manuali i standarteve europiane të vlerësimit**”, në normat bashkëkohore të trajtuara nga ky manual. Gjithashtu, në realizimin e vlerësimit jam përpjekur të marr në konsideratë dhe vlerën aktuale të tregut për objektet e ngjashme me pronën tonë objekt vlerësimi.

Raporti i paraqitur për vlerësimin e këtij objekti, të cilësohet si konfidencial. Pra, vlefshmëria e tij t’i shërbejë vetëm te interesuarit, për qëllimet e saj.

Procesi i përcaktimit të vlerës së një prone është një proces kompleks, jo thjesht vetëm llogaritës. Një gjë e tillë ndodh sepse në madhësinë e vlerës të pronës ndikojnë disa faktorë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, si: zotërimi i pronës; vendndodhja, përshkrimi dhe sipërfaqet e saj; urbanistika dhe infrastruktura e zonës në të cilën ndodhet prona, etj. Për të

bërë një vlerësim sa më objektiv të saj, më duhet t'i marr në konsideratë të gjithë këta faktorë.

1. Zotërimi i Pronës

Sipas "Certifikates Per Vertetim Pronesie" i lëshuar në dt. 29/08/2012, pronar i pronës në fjalë rezulton të jetë **Bashkia Korçe**. Pasuria me **nr. 4/33**, ndodhet në zonën kadastrale **nr. 8564**, e regjistruar sipas hartës treguese, në **volumin 35, faqe 190**.

2. Vendndodhja e Pronës

Prona objekt vlerësimi ndodhet në qytetin e Korçës, tek ish ndërmarrja e U.I.K.

Ajo kufizohet:

- Në Veri, nga prona 4/95;78.
- Në Lindje, nga prona 4/78;41.
- Në Jug, nga prona 34/77 4/35
- Në Perëndim, nga prona 4/35;34.

3. Sipërfaqet

Sipas dokumentacionit të mësipërm, marrë në ZRPP Korçë dhe nga verifikimi në vend i pronës, sipërfaqja totale e saj është **22.800 m²**.

Urbanistika dhe Infrastruktura

Sipërfaqja e tokës është truall ndërtimi, meqenëse ndodhet brenda të ashtuquajturës “vijë të verdhë” të qytetit. Trualli që do të vlerësohet ka akses të drejtpërdrejtë në rrugët përshkruese të zonës, e cila është një zonë me trafik jo të kufizuar. Nga kjo, trualli objekt vlerësimi mund të përdoret dhe si shesh ndërtimi, në rast se do të ketë një plan studimi.

5. Përshkrimi i Pronës

Prona që do të vlerësohet ndodhet në zonën jugperëndimore, periferike të qytetit të Korçës, pikërisht në skajin verior të Tregut të Shitjes me Shumicë të Fruta-Perimevedhe ish T.E.C it KorcePjesa lindore nga ish U.M.B Korce dhe gjithë pjesa veriore ka dalje te drejtperdrejte me rrugen hyrese te qytetit

Trualli, objekti ynë i vlerësimit, pjesë e ish U.I.K. Korçë, në jug të teritorit të kësaj uzine, e rrethuar nga objekte të tjera me karakter industrial (magazine), në një largësi nga pika e nisjes së furgonave, pranë City Center. Aksesit i pronës në rrugën Unazë të qytetit, si dhe në rrugën kryesore të qytetit, realizohet nëpërmjet rrugëve të brendëshme përshkruese të ish U.M.B. Ajo ndodhet në një distancë prej rreth 500 m nga qendra e qytetit, rreth 200 m nga Pazari i Korçës. Në momentin e vlerësimit, prona objekt jonë i vlerësimit

është e parrethuar dhe pasistemuar. Duke parë kartelen e pasurisë së paluajtshme të pronës në seksionin D të saj (**seksioni i qirave, marrëveshjeve kufizuese servituteve dhe interesave të tjera**) tek përshkrimi, mbi këto truall ndodhen tre objekte të ndertuara dhe konkretisht : **Pasuria me nr 4/33-ND1; Pasuria me nr 4/33-ND2 dhe Pasuria me nr 4/33-ND3**, por jo objekt vlerësimi .

6. Vlerësimi

Të gjithë elementët e mësipërm përshkruar të pronës u paraqitën me qëllimin përfundimtar: përcaktimin e vlerës aktuale të saj. Në lidhje me vlerësimin e objektit pasuri e paluajtshme, pronë e Bashkia Korce, meqënëse kemi të bëjmë me truall, si metodë vlerësimi do të përdoret “Metoda e Krahasimit të Drejtpërdrejtë”.

Çdo pronë është unike në llojin e saj, pra nuk mund të bëhet fjalë asnjëherë për prona identike. Por, megjithatë mund të flitet për ngjashmëri midis pronave. Pikërisht kjo

7. Konkluzion

Prona objekt ynë vlerësimi, truall, e ndodhur në qytetin e Korçës, sipas Çertifikatës për “Vërtetim Pronësie” të dt. 29/08/2012, me numër pasurie 4/33, lëshuar nga ZRPP Korçë, në pronësi të **Bashkia Korçe**, ka si vlerë aktuale tregu shumën **319.200.000 lek.**

8. Rezervime

Për vlerësimin e pronës në fjalë u morën për bazë vlerat aktuale të tregut për pasuri të ngjashme, por megjithatë nuk parashikohen ndryshimet që mund të pësojnë koeficientët e veçantë të vlerësimit në të ardhmen.

Raporti përmban supozimin se pronësia është e pastër, kushtet për përdorimin e tanishëm dhe për atë të ardhshëm janë të ligjshme dhe që pronë është regjistruar në ZVRPP Korçë.

Për vlerësimin e pronës në fjalë u morën për bazë vlerat aktuale të tregut për pasuri të ngjashme.

Theksoj se gjykimet janë dhënë në bazë të vëzhgimeve dhe komentet kufizohen në inspektimet sipërfaqësore që mund të bëja. Gjuha e përpilimit të raportit është “shqipja” se monedha e vlerësimit është “leku”.

Data e inspektimit të pronës, 27.10. 2013.

Data përgatitjes “Raportit të Vlerësimit”, 30/10/2013

Ekspert Vlerësues

Jani Stratobërdha

Adresa: Rr. “Mihal Grameno” Nr. 2, Lagja 3, Korçë





Map

Photos

Rruga 1 Maj

Vendë Godhja e prënës nr 33

Bashkia Korce

Rruga Mihal Kestani

Rruga Margo Pozio

Rruga Klod

SHT5

SHT5

100 m

50 m



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

658814

Zyra e Regjistrimit P. P. KORÇE Zona Kadastrale Nr. 8564
 Numri i Pasurisë 4/33 Volumi 35 Faqe 190
 Adresa e Pasurisë KORÇE
 Lloji i Pasurisë TRUALL
 Sipërfaqja Totale 22 800 m²
 Nga kjo : Sa Truall 22 800 m² Nga kjo : Sa Ndërtesa -
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>BASHKIA</u>		<u>KORÇE</u>	<u>I</u>	<u>KORÇE</u>

- është pronar i PAS 4/33
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart -
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi -
- kufizimet e pasurisë janë : V 4/95: 4/78 , L 4/78: 4/41 , J 4/77: 4/35 , P 4/35: 4/34

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 23.08.2012 Nr. 636

Data e lëshimit të çertifikatës
29. GUSHT. 2012

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
(KOÇO BELLO)

